



**Procesverbali nga Dëgjimi Publik me banorët e fshatit Bllacë  
për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029**

Dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave Bllacë u mbajtë më: 20.05.2026 në SHFMU “Ramë Bllaca” në Bllacë, Komuna Suharekë, me fillim në ora 19:00.

Dëgjimin e shpalli të hapur Kryetari i fshatit Bllacë, z.Maksut Pirku, i cili përshëndeti pjesmarrësit, qytetarët dhe stafin Komunal të përbërë nga : Amir Hoxhën- Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Kymete Bajraktarin-Drejtoreshën për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si dhe Florinda Isufaj-Zyrtare Ligjore në DSHPE.

**Kymete Bajraktari-** Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, përshëndeti dhe falenderoi pjesmarrësit, duke filluar prezantimin e Planifikimit Buxhetore për vitin 2027-2029. Ajo theskoi se ky takim është organizuar për të ndëgjuar kërkesat dhe nevojat e qytetarëve për shqyrtim të mëtejshëm.

**Amir Hoxha -** Amir Hoxhën- Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, përshëndeti dhe falenderon pjesmarrësit, prezantoi investimet kapitale të planifikuara për vitin 2026, si dhe i njofton banorët që sipas kërkesave të kryesisë së fshatit në bashkëpunim me përfaqësuesit e lagjeve procedura e inicimit për rregullimin e rrugëve në fshatin Bllacë për vitin 2026 i është dorëzuar Zyrës së Prokurimit.

**Maksut Pirku-** Problemi kryesor në fshat është problem me kanalizime, mbi 23 shtëpi mbi Xhaminë e fshatit nuk kanë fare kanalizim, tek Lagja Zekolli gypat e rrjetit të kanalizimit janë të bllokuar, sidomos gjatë stinës së verës ka kundërmim, përafërisht në tërë fshatin nevojitet rreth 4km shtrirje të kanalizimit duke përfshirë sanim, gypa etj. Sa i përket ndriqimit public rreth 30% e fshatit nuk ka fare ndriqim. Tek Kulla e Dëshmorëve nuk ka rrethoja.

Ujsjellësi është vetëm 60% i përfshirë në tërë fshatin, kërkon që Komuna në bashkëpunim me Hidroregjionin të përfshihen të gjitha lagjet e fshatit.  
Trotuare në dalje të fshatit tek rruga “Alush Rexhepi” rreth 400m.

**Fehmi Zekolli-** Në rrugën “ Sali Kermenit” rrjeti i kanalizimit është i bllokuar.

**Musa Elezi-** Te ura e “Sherif Hoxhës” kanalizimi është i bllokuar.

**Hajrush Suka-** Ka nevojë për hapje të lumit prej urës së Sherif Hoxhës dhe prej lagjes Zekolli.

**Nazmi Kyqyku-** Në rrugë e “UÇK”-së janë shtatë shtëpi që rrjetin e kanalizimit e kanë të bllokuar.

**Urim Kyqyku-** Kërkon rrugën tek varrezat së paku të shtrohet me zhavorr, po ashtu edhe rregullimin e parkingut te shkolla.

**Shefket Hoxha-** Në rrugën kryesore ujërat atmosferik po përfshijnë oborret e shtëpive, të vendosen gypa deri në fund të rrugës.


**Milazim Lumi**- Përgëzon Komunën për projektet e realizuara në fshatin Bllacë, potencon që prioritet për projektet e radhës të jet shtrirja, sanimi i kanalizimeve në fshat, të bëhet përfundimi I shetitorës e cila ka mbet në gjysmë si dhe të sanohet ndriqimi public në tërë fshatin.

**Të gjithë të pranishmit pajtohen që për vitin 2027 prioritet të jet rrjeti i kanalizimit në fshat, pastaj të bëhet ndërtimi i rrugëve sipas mundësive buxhetore.**

**Maksut Priku**-Falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm ndër vite.

Takimi përfundoi në orën : 20:40

Procesmbajtëse : Florinda Isufaj





Lista e pjesëmarrësve në dëgjime publike në BLLACË ORA 19:00

Date: 20.05.2026

Nr	Emri dhe mbiemri	Vendi	Nënshkrimi	Nr.tel
1	Maksut Pula	Bllacë		044-186-884
2	Mirza Xexi	Bllacë		049302989
3	Burim Zealli	Bllacë		044-823-438
4	Betim Balli	Bllacë		044/133-905
5	Ali Balli	Bllacë		049 804 235
6	Musti Balli	Bllacë		044-923-458
7	Hajrulla Suka	Bllacë		044/854-884
8	Shefket Shaxha	Bllacë		049-187-067
9	ISLAM ZEZI	BLLACË		044-297-6
10	Fehmi Zekolli	BLLAC		049-425-31
11	Nazim Kyzyku	Bllacë		049426488
12	DEMOKRAT HOGUKU	BLLACË		049,994,984
13	Melzer Zekolli	Bllacë		044823348
14	Urim Kyzyku	Bllacë		044834285
15	Milazim Lemi	Bllacë		044624632
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				